

# *UNIVERSITETI HASAN PRISHTINA*

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

STUDIMET MASTER



## TEMA E MASTERIT

**Tema: “ANALIZA DINAMIKE E VINÇIT GJYSMËPORTAL  
ME KAPACITET BARTËS PREJ 6.3 TON”**

**Mentori:**

*Prof. Dr. Ilir Doci*

**Kandidati:**

*Albert Isufi*

**Prishtinë, 2018**



**PËRMBAJTJA**

1.	Hyrje	3
2.	Kapitulli I ..... Dinamika teorike e vinçit të repartit	5
3.	Kapitulli II .... Karakteristikat teknike të vinçit gjysmëportal të repartit	14
4.	Kapitulli III ... Llogaritjet statike të vinçit gjysmëportal	16
5.	Kapitulli IV .... Modelimi i pjesëve të vinçit me softverin Inventor	24
6.	Kapitulli V ..... Analiza e forcave dhe momenteve të pjesëve kryesore të vinçit gjatë ngritjes së ngarkesës	29
7.	Kapitulli VI .... Analiza e forcave dhe momenteve të pjesëve kryesore të vinçit gjatë lëshimit të ngarkesës	43
8.	Kapitulli VII .... Analiza e sforcimeve, deformimeve dhe zhvendosjeve të pjesëve kryesore të vinçit gjatë proceseve të punës	47
9.	Përfundimi ..... 59	
10.	Literatura ..... 61	

## HYRJE

Në këtë punim kemi marrë për analizë vinçin gjysmëportal i prodhuar nga firma "SAMO" nga Italia i cili është i montuar në repartin e Konstruksioneve metalike të IMK-së në Ferizaj në vitin 2016. Tipi i vinçit M4483, të dhënat teknike janë marrë nga manualët dhe shënimet e prodhuesit Samo: peshëngritja, shpejtësia e ngritjes së peshës, shpejtësia e karrocës, shpejtësia e vinçit, dimensionet e trarëve kryesor, dimensionet e rrotëve, etj, janë të paraqitura edhe në literaturë.

Shënimet tjera për realizimin e punimit të temës janë marrë me matjet e realizuara në vinç siq janë: dimensionet e konstruksionit metalik (trarët e bazamentit, trarët anësorë dhe trarët e sipërm), dimensionet e karrocës dhe binarëve të karrocës, dimensionet e binarëve, dimensionet e mekanizmit të ngritjes (makaratë, çengeli, litari, tamburi), hapësira punuese, lartësia e ngritjes. Për analizë sa më të detajizuar të vinçit, do të modelohet i tërë vinçi me anë të softverit për modelim Autodesk Inventor, ndërsa simulimet dhe përfitimet e rezultateve do të bëhen me anë të softverit SimWise 4D.




Fig. 1. Vinçi gjysmëportal i shqyrtuar në punim

## Identifikimi dhe përshkrimi i problemit

Me ndihmën e softverit *SimWise 4d* do të bëhet simulimi i vinçit të modeluar paraprakisht. Ky softver është i avansuar për analiza dinamike të sistemeve makinerike dhe jep mundësi për hulumtim të mirëfilltë shkencor për këtë lloj të vinçit nga aspekti i analizës dinamike.

Rezultatet e fituara do të jepen në formë të grafikëve ku paraqitet shpërndarja e forcave, momenteve, sforcimeve, deformimeve dhe zhvendosjeve si dhe në formë të shpërndarjes sipërfaqësore të parametrave të sforcimeve dhe deformimeve.

### *Në analizën dinamike të vinçit gjysmëportal do të analizohen:*

1. - Analiza e litarëve gjatë ngritjes së ngarkesës maksimale
1. - Analiza e litarëve gjatë lëvizjes së karrocës me ngarkes maksimale
2. - Analiza e litarëve gjatë lëvizjes drejtëvizore të vinçit gjysmëportal me ngarkesë maksimale
3. - Forca në dy mbështetësit anësor gjatë ngritjes së ngarkesës
4. - Forca në dy mbështetësit gjatë lëvizjes së karrocës me ngarkes maksimale
5. - Forca në dy mbështetësit gjatë lëvizjes drejtëvizore të vinçit gjysmëportal me ngarkesë maksimale
6. - Sforcimet në dy trarët e sipërm të vinçit gjatë ngritjes së ngarkesës maksimale
7. - Sforcimet në dy trarët e sipërm të vinçit gjatë lëvizjes së karrocës me ngarkesë dhe
8. - Sforcimet e dy trarëve të sipërm gjatë lëvizjes drejtëvizore të vinçit me ngarkesë maksimale.
9. Me realizimin e kësaj analize do të kemi një pasqyrë më të qartë në lidhje me veprimin e ngarkesave dinamike në trarët, ndemjet që paraqiten, lëkundjet në vinç në pjesët e caktuara të tij, si dhe veprimi i këtyre forcave në binarët e vinçit.

## Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit është analiza dinamike e vinçit gjysmeportal të repartit me ngarkesë maksimale dhe në lartësi maksimale, me aplikimin e softverëve të modelimit dhe simulimit. Me realizimin e kësaj analize do të kemi një pasqyrë të qartë në lidhje me veprimin e ngarkesave dinamike në vinç, ndemjet që paraqiten, lëkundjet në vinç në pjesët e caktuara të tij, si dhe veprimi i këtyre forcave në pjesët kryesore të vinçit. Pasi ky lloj i vinçit nuk është analizuar në aspektin dinamik tek ne, ky do të jetë kontributi kryesor i këtij punimi.

## KAPITULLI I

### 1. DINAMIKA TEORIKE E VINÇIT TË REPARTIT

#### 1.1 BAZAT TEORIKE TË ANALIZËS DINAMIKE TË VINÇIT GJYSËMPORTAL

Pas analizës së proceseve punuese reale të vinçave të hulumtuar, duhet të zgjidhet skema llogaritëse e cila mund të thjeshtohet me marrjen në shqyrtim të parametrave të ndryshëm. Pastaj rekomandohet përvetësimi i modelit përfundimtar, verifikimi i tij me eksperimente dhe përpunimi llogaritës. Vinçi gjysmëportal (si dhe vinçat në përgjithësi) dallohen me renditjen e veçantë të tërësive (i karakterizojnë masat përkatëse, ngurtësitë dhe shuarjet), prandaj nga aspekti i analizës dinamike mund të vërtetohet se vinçi posedon numër pafundësisht të madh të shkallëve të lirisë. Mekanizmat e vinçave, si dhe konstruksioni bartës elastik paraqesin sistemin e përbërë oscilues që i nënshtrohet lëvizjeve oscilatore në rrafshin vërtikal.[2], [10].

Në hulumtimet e gjertanishme, influencimet më të shpeshta të shqyrtuara janë ligjshmëritë e ndryshimit të forcave ngasëse, elasticiteti i strukturës bartëse të vinçit në rrafshin vertikal dhe mënyra e diskretizimit (thjeshtimit) të saj, shuarja e lëkundjeve elastike të litarit, të strukturës bartëse dhe elementeve të mekanizmave ngasës.

Me zhvillimin dhe aplikimin e teknikës llogaritëse dhe mbështetjes softverike në analizën statike dhe dinamike të sjelljes së vinçit, është mundësuar shqyrtimi i sistemeve shumë të komplikuar me numër shumë të madh të faktorëve influencues [2], [4].

Megjithatë, është e domosdoshme që të bëhen disa thjeshtime. Këso qasje mund të kemi atëherë kur madhësitë e veçanta kanë influencë të vogël në problemin e analizuar, si dhe kur influenca e nxjerrur nga këto madhësi gjithashtu është e vogël. Duhet gjithashtu të dihet që me futjen e numrit më të madh të madhësive të cilat analizohen në model, nuk fitohen gjithnjë të dhënat mbi sjelljen reale të vinçit [10].

Rezultatet e fituara gjatë studimit të gjendjes dinamike të vinçit ndikojnë në formimin e vlerave të koeficientëve dinamik të cilët përfaqësohen në rregullat për projektimin e vinçave. Zhvillimi bashkëkohorë i vinçave kërkon rritjen e ngarkesave dhe shpejtësive punuese me qëllim të produktivitetit sa më të madh. Zhvillimi i kompjuterëve ka ndikuar shumë në zgjidhjen e problemeve dinamike. Modelimi i konstruksionit si fazë e domosdoshme, me shfrytëzimin e kompjuterit ka një rendësi të madhe. Hulumtimet eksperimentale paraqesin verifikimin e rëndësishëm të parashtrimeve teorike, prandaj zhvillimi i teknikës matëse është faktor i pashmangshëm.

## 1.2. KRIJIMI I MODELIT MATEMATIKOR TË VINÇIT

Modelet matematikore e aproksimojnë strukturën e vinçit duke e diskretizuar vinçin në elementë të thjeshtë që mund të analizohen me anë të ekuacioneve diferenciale. Këta elementë mund të jenë trupa të thjeshtë gjeometrik me masë, susta elastike, masa të koncentruara, trupa ku masa neglizhohet, etj. Për zgjidhjen e ekuacioneve diferenciale mund të përdoren metodat numerike matematikore si dhe kompjuterët. Shkalla e diskretizimit të vinçit duhet të jetë deri në atë masë që të mos ndryshojë gjendjen reale të vinçit, duke përfshirë pjesët e vinçit dhe lidhjet në mes tyre.

Krijimi i modelit matematikor mund të bëhet sipas këtyre kriterëve [12]:

- zgjedhja e llojit të modelit matematikor ose skemës ekuivalente të mekanizmave të vinçit,
- përcaktimi i masave të elementëve dhe ngurtësisë së lidhjeve,
- përcaktimimi madhësisë dhe karakterit të ndryshimit të ngarkesave të jashtme të cilat veprojnë në sistem,
- vendosja e ekuacioneve diferenciale të lëvizjes së masave të sistemit,
- sjellja e forcave elastike dhe momenteve në pjesët përbërëse të mekanizmit.

Llojet e modeleve matematikore mund të jenë [10]:

- Modelet matematikore të sistemeve të ngurta,
- Modeli matematikor i sistemit elastik me aplikimin e matricës së transmetimit,
- Modeli matematikor i sistemit elastik me aplikimin e metodave numerike për zgjidhjen e problemit,
- Modeli matematikor i sistemit elastik me aplikimin e matricave të elementëve të veçantë që e përshkruajnë në tri dimensione.

Ngarkesat dinamike punuese janë më të rëndësishmet dhe kanë karakter oscilues.

Zhvillimi i kompjuterëve ka ndikuar shumë në zgjidhjen e problemeve dinamike. Modelimi i konstruksionit si fazë e domosdoshme, me shfrytëzimin e kompjuterit ka një rendësi të madhe [2]. Hulumtimet eksperimentale paraqesin verifikimin e rëndësishëm të parashtrimeve teorike, prandaj zhvillimi i teknikës matëse është faktor i pashmangshëm

Vinçi gjysmëportal është vendosur në një platformë ngarkim-shkarkimi. Përshkrimet e sistemeve të tilla mund të përdoren në procesin e projektimit të sistemeve të kontrollit e cila na lejon për të kompensuar lëkundjet. Transformimet homogjene dhe koordinatat e bashkuara janë përdorur për të përshkruar sjelljen e sistemit. Ekuacionet e lëvizjes janë përfituar duke përdorur ekuacionet e Lagranzhit të rendit të dytë [2]. Në teori janë të pranishme poashtu edhe rezultatet e llogaritjeve numerike.

Analizat dinamike e sistemeve të montuara janë kryesisht të vështira sepse duhen marrë parasysh fenomenet e lëkundjes së ngarkesës. Ngarkesa shkakëton lëvizje shtesë në bazë (platformë) dhe në këtë mënyrë ka shtytje të fuqishme në sistem të cilat do të mirren parasysh në proceset e projektimit, jo vetëm në analizat e sforcimeve apo tensionit por edhe në projektimin e lëvizjes dhe të sistemit të kontrollit.

Në teori transformimet homogjene dhe koordinatat e bashkuara janë përdorur për të përshkruar analizat dinamike të vinçit gjysmëportal. Ekuacionet e lëvizjes janë formuluar duke përdorur ekuacionet e Lagranzhit të rendit të dytë.

### 1.3 MODELI MATEMATIKOR

Vinçi gjysmëportal fig. 2. është konsideruar si sistem me 12 shkallë lirie. Korniza  $\{F\}$  është trajtuar si trup i ngurtë (6 shkallë lirie) i lidhur me platformën  $\{D\}$  përmes bazës me susta të amortizuara. Edhe ngarkesa poashtu është trajtuar si trup i ngurtë në lidhje me platformën  $\{D\}$ . Ngarkesa është e lidhur me kornizën me anë të katër litarve elastikë [1].

Është supozuar se lëvizja e platformës është njohur.



Rrjedhimisht pozicioni i sistemit koordinativ  $\{D\}$  në lidhjet me sistemet e koordinative globale  $\{0\}$  është njohur.

Pozicioni i sistemit koordinativ  $\{D\}$  në lidhje me  $\{0\}$  është përcaktuar nga:

$$\left. \begin{aligned} x^{(D)} &= x^{(D)}(t) \\ y^{(D)} &= y^{(D)}(t) \\ z^{(D)} &= z^{(D)}(t) \end{aligned} \right\} \text{koordinatat e origjinës së sistemit koordinativ } \{D\} \text{ në } \{0\}. \quad (1)$$

$$\left. \begin{aligned} \Psi^{(D)} &= \Psi^{(D)}(t) \\ \theta^{(D)} &= \theta^{(D)}(t) \\ \varphi^{(D)} &= \varphi^{(D)}(t) \end{aligned} \right\} \text{Këndet Euler (1) të cilat përshkruan ndonjë orientim të mundëshëm} \\ \text{të } \{D\} \text{ në } \{0\}. \quad (2)$$




Fig. 2. Modeli i vinçit gjysmëportal.

Lëvizja e kornizës  $\{F\}$  dhe ngarkesës  $\{L\}$  në lidhje me platformën  $\{D\}$  janë përshkruar nga parametrat e pavarur të cilat janë komponentet e vektorëve.

(3)

$$q^{(F)} = \left[ x^{(F)} \ y^{(F)} \ z^{(F)} \ \psi^{(F)} \ \theta^{(F)} \ \phi^{(F)} \right]^T,$$

(4)

$$q^{(L)} = \left[ x^{(L)} \ y^{(L)} \ z^{(L)} \ \psi^{(L)} \ \theta^{(L)} \ \phi^{(L)} \right]^T.$$

Është supozuar se korniza  $\{F\}$  është e lidhur me platformën me anë të bazës me susta të amortizuara me vlera të mëdha të ngurtësisë dhe koeficientin e zbutjes së dridhjeve.

Këndet  $(\phi, \varphi^{(F)}, \theta^{(F)}, \Psi^{(F)}, \varphi^{(L)}, \theta^{(L)}, \Psi^{(L)})$  janë të vogla dhe matricat transformuese nga sistemi koordinativ  $\{F\}$  dhe  $\{L\}$  tek  $\{D\}$  mund të paraqitet në formën lineare [3 dhe 4].

(5)

$$B^{(F)} = \begin{bmatrix} 1 & -\psi^{(F)} & \theta^{(F)} & x^{(F)} \\ \psi^{(F)} & 1 & -\varphi^{(F)} & y^{(F)} \\ -\theta^{(F)} & \varphi^{(F)} & 1 & z^{(F)} \\ 0 & 0 & 0 & 1 \end{bmatrix},$$

$$B^{(L)} = \begin{bmatrix} 1 & -\psi^{(L)} & \theta^{(L)} & x^{(L)} \\ \psi^{(L)} & 1 & -\varphi^{(L)} & y^{(L)} \\ -\theta^{(L)} & \varphi^{(L)} & 1 & z^{(L)} \\ 0 & 0 & 0 & 1 \end{bmatrix}. \tag{6}$$

Matricat transformuese nga sistemet lokale koordinative  $\{F\}$  dhe  $\{L\}$  në sistemet koordinative globale  $\{0\}$  mund të shkruhet në këtë mënyrë.

(7)

$$B^{(F)} = A^{(D)} B^{(F)} (q^{(F)})$$

$$B^{(L)} = A^{(D)} B^{(L)} (q^{(L)}) \tag{8}$$

Ku:

$$A^{(D)}(t) = \begin{bmatrix} c\psi^{(D)} & c\theta^{(D)} & c\psi^{(D)} & s\theta^{(D)} & s\varphi^{(D)} & -s\psi^{(D)} & c\varphi^{(D)} & c\psi^{(D)} & s\theta^{(D)} & c\varphi^{(D)} & +s\psi^{(D)} & s\varphi^{(D)} & x^{(D)} \\ s\psi^{(D)} & c\theta^{(D)} & s\psi^{(D)} & s\theta^{(D)} & s\varphi^{(D)} & +c\psi^{(D)} & c\varphi^{(D)} & s\psi^{(D)} & s\theta^{(D)} & c\varphi^{(D)} & -c\psi^{(D)} & s\varphi^{(D)} & y^{(D)} \\ & -s\theta^{(D)} & & c\theta^{(D)} & s\varphi^{(D)} & & & & & c\theta^{(D)} & c\varphi^{(D)} & & z^{(D)} \\ & 0 & & & & 0 & & & & & 0 & & 1 \end{bmatrix}$$

Ekuacionet e lëvizjes janë përfituar duke përdorur ekuacionet e Langranzhit të rendit të dytë.

$$\frac{d}{dt} \frac{\partial E}{\partial \dot{\varphi}_k} - \frac{\partial E}{\partial \varphi_k} + \frac{\partial V}{\partial \varphi_k} + \frac{\partial D}{\partial \dot{\varphi}_k} = Q_k, \quad k = 1, \dots, 12,$$

(9)

Ku:  $E$  - është energjia kinetike e sistemit,  $V$  - është energjia potenciale e forcës së gravitetit,  $D$  - është shpërndarja e energjisë së sistemit.  $Q_k$  janë forcat e përgjithësuara jo-potenciale,  $q_k$ ,  $\dot{\varphi}_k$  janë koordinatat përgjithësuara dhe shpejtësitë, përkatësisht - komponentet e vektorëve.

Energjia kinetike e sistemit, energjia potenciale e forcës së gravitetit dhe derivatet e saj mund të jenë të llogaritura si është paraqitur në (9).

Fig. 3. Paraqet lidhjen e ngarkesës dhe litarëve. Ngritja e ngarkesës është me anë të litarëve. Në modelin matematikor të vinçit gjysmëportal, sistemi i ngritjes është reduktuar në katër litar elastikë.



*Fig. 3. Sistemi i ngritjes së vinçit*

Fig. 5. Paraqet mënyrën e lidhjes së vinçit me dyshemenë. Sistemi është i mbështetur në shinat e ngurtë.



*Fig. 5. Lidhja e vinçit gjysmëportal me dyshemenë.*

Fig. 5. Paraqet modelin e lidhjes elastike të kornizës së këmbëve me dyshemenë (pika  $P^{(k)}$ ),




Fig. 6. Lidhja elastike e kornizës me platformën.

Struktura e ekuacioneve të lëvizjes është e ndryshme dhe varet në funksionet e përzgjedhura të lëvizjes së kornizës në drejtimin  $X^{(D)}$ .

A. sistemi i lëvizjes elastikë.  $A \mathfrak{q} = f,$  (10)

B. sistemi i lëvizjes së ngurtë  $A \mathfrak{q} - DF = f,$  (11)

$$D^T \mathfrak{q} = \mathfrak{Q}$$

Ku:

$$q = \begin{bmatrix} q^{(F)} \\ q^{(L)} \end{bmatrix}$$

$$F = \begin{bmatrix} F_x^1 \\ F_x^4 \end{bmatrix}$$

A është matricë konstante,

$$f = f(t, C, \mathfrak{q}),$$

$\delta = \begin{bmatrix} \delta_1(t) \\ \delta_2(t) \end{bmatrix}$  Është vektori duke e përshkruar zhvendosjen e pikave  $P^{(1)}$  dhe  $P^{(4)}$  në drejtimin  $X^{(D)}$ .

Modeli dinamik i vinçit gjysmëportal konsiderohet se është përshkruar prej 12 (ek. 10) ose 14 (ek. 11) ekuacione diferenciale të zakonshme të rendit të dytë.

Në mënyrë që të integrohen në ekuacionet e lëvizjes është përdorur metoda Runge-Kutta me përmasa vepruese kostante.

Kemi supozime që  $\phi \equiv 0$ ;  $\dot{\phi} \equiv 0$  në ek. 10 dhe ek. 11 vektori  $q$ , forcat kundërvepruese në litar dhe në bazën me susta të amortizuara mund të llogariten. Në këtë rast sistemi është përshkruar nga grupi i ekuacioneve jolineare.

$$F(t, \zeta) = 0 \quad (12)$$

Varësia e  $F$  kundrejt  $T$  është shkakëtuar nga shprehjet e lidhura me bazën e lëvizjeve të dyshemesë. Ekuacionet (12) janë zgjedhur duke përdorur metodën përsëritëse të Njutonit.

## KAPITULLI II

### 2. KARAKTERISTIKAT TEKNIKE TË VINÇIT GJYSMËPORTAL TË REPARTIT M4483

#### 2.1. KARAKTERISTIKAT E VINÇIT: [4]

Ngarkimi i karrocës	- 6.3 ton
Gjatësia lëvizese	- 7 [m]
Gjatësia e urës (hapësira punuese)	- 11.5 [m]
Shpejtësia gjatësore lëvizëse	-10.40 [m/min]
Fuqia hargjuese	- 0.75 [kW]
Shpejtësia e motorit në rrotullime për minut	- 1375 [rrot/min]
Raporti i transmisionit	- 25.06 [i]
Diametri i rrotave	- 200[mm]
Hapsira punuese dhe diametri i rrotave të karrocës	- 2500/3600 [mm]
Tipi i dhëmbzorëve - boshti ortogonal	
Voltazha kryesore	- 400/50 [V/Hz]
Tipi i frenave, elektromagnetike me disk frenues, [4]	

## 2.2. KARAKTERISTIKAT E KARROCËS

Hapsira punuese	- 1200 [mm]
Madhësia e rrotave të karrocës	- 950 [mm]
Diametri i rrotave	- 160 [mm]
Shpejtësia lëvizëse	- 5.20 [m/min]
Fuqia hargjuese	- 0.37 [kW]
Shpejtësia e motorrit	- 1360 [rrot/min]
Tipi i dhëmbëzorit - Boshti paralel	
Raporti i transmisionit	- $i = 41.07$
Tipi i frenave – me disqe elektromagnetike	
Tensioni i rrymës elektrike	- V/Hz -- 400/50, [4]

## 2.3. KARAKTERISTIKAT NGRITËSE TË VINÇIT GJYSMËPORTAL

Tipi – XM316NS4H7A/5	
Prodhuesi – MISIA	
Viti i prodhimit – 2015	
Ngarkesa bartëse	6300 [kg]
Diametri i litarit	10 [mm]
Diametri i tamburit	219 [mm]
Diametri i makarës	243 [mm]
Shpejtësia ngritëse	1,3/4 [m/min]
Fuqia hargjuese	1,5/4,5 [kW], [4]



## **KAPITULLI III**

### **3. LLOGARITJET STATIKE TË VINÇIT GJYSMËPORTAL**

#### **3.1 CAKTIMI I REAKSIONEVE PËR RAMIN E DHËNË.**

Për ramin e dhënë me ngarkesë  $G = 6300$  [kg], dhe nga pika A deri te pika B me gjatësi  $l = 11500$  [m], do të i shtrojmë kushtet e ekuilibrit dhe do të i paraqesim diagramet statike si në vijim.




Fig. 3.1. Rami i dhënë

**Kushtet e ekuilibrit:**

$$1. \sum X_i = 0; F_{XA} = 0 \dots (1)$$

$$2. \sum Y_i = 0; F_{YA} + F_{YB} - q \cdot l - G'_{tr} - G'_{ts1} - G'_{ts2} - G'_{ts3} - G_{sht} = 0; \dots (2)$$

$$3. \sum M_A = 0; F_{YB} \cdot l - G'_{ts3} \cdot l - G'_{tr} \cdot l/2 - q \cdot l \cdot l/2 = 0; \dots (3)$$

$$(3) \Rightarrow F_{YB} = G'_{ts3} + G'_{tr}/2 + q \cdot l/2$$

$$F_{YB} = 0.5 + 17.96/2 + 3.1 \cdot 11.5/2$$

$$F_{YB} = 0.5 + 8.98 + 17.82$$

$$F_{YB} = 27.3 \text{ [kN]}$$

$$(2) \Rightarrow F_{YA} = -F_{YB} + q \cdot l + G'_{tr} + G'_{ts1} + G'_{ts2} + G'_{ts3} + G_{sht}$$

$$F_{YA} = -27.3 + 35.65 + 17.96 + 0.94 + 0.735 + 0.5 + 3.4$$

$$F_{YA} = 31.88 \text{ [kN]}$$

$$(1) \Rightarrow F_{XA} = 0$$

**Të dhënat:**

$$G_n = 63 \text{ [kN]}$$

*Pesha e ngarkesës.*

$$G_k = G_{tamb} + G_{EM} + G_{polis} = 4.18 \text{ [kN]}$$

*Pesha e karrocës.*

$$G'_{tr} = G_{tr} + G_{bin} = 17.96 \text{ [kN]}$$

*Pesha e trarëve.*

$$G_{shl} = 3.4 \text{ [kN]}$$

*Pesha e shtyllave.*

$$G'_{ts1} = 0.94 \text{ [kN]}$$

*Pesha e traut sekondar1.*

$$G'_{ts2} = 0.735 \text{ [kN]}$$

*Pesha e traut sekondar2.*

$$G'_{ts3} = 0.5 \text{ [kN]}$$

*Pesha e traut sekondar3.*

Që do të thotë se:

$$G'_n = G_n / 2 = 63 / 2 = 31.5 \text{ kN}$$

$$G_{total} = G'_n + G_k = 31.5 + 4.18 = 35.68 \text{ [kN]}$$

$$q = G_{total} / L = 35.68 / 11.5 = 3.1 \text{ [kN/m]}$$

### 3.2. Llogaritja e forcës në litar

Shumfishiteti i polispastit (raporti i transmisionit të polispastit) të vinçit përcaktohet:

$$i^{po} = \frac{m}{a} = \frac{4}{2} = 2$$

ku janë:

$m = 4$  – numri i degëve të litarit mbi të cilat varet ngarkesa  $Q$ .

$a_t = 2$  – numri i degëve që mbështillet në të njëjtën kohë në tambur.

Për polispastin njësh  $a_t = 1$ , ndërsa për polispastin dysh  $a_t = 2$ .

Koeficienti i punës së dobishme të polispastit përcaktohet:

Për ngritje:

$$\eta_{po}^{ng} = \frac{(1 - \eta^{i_{po}}) \eta^1}{i_{po} (1 - \eta)} = \frac{(1 - 0.98^2) \cdot 0.98^1}{2 \cdot (1 - 0.98)} = \frac{0.0388}{0.04} = 0.97$$

$t = 1$  – numri i makareve devijuuese

Forca në krahun tërheqës të litarit që mbështillet në tambur për rastin kur ngarkesa është në gjendje të qetësisë, është:

$$F_o = \frac{Q}{m} = \frac{G_n}{m} = \frac{100}{4} = 25(kN) \quad A = \pi r^2 \quad (63/4)=15.75/0.97=16.24$$

Forca në krahun tërheqës të tamburit kur ngarkesa ngritet, është:

$$F_{mg} = F_{mak} = \frac{F_o}{\eta_{po}^{ng}} = \frac{25}{0.97} = 25.77(kN)$$

Softueri IQ 100 është paket program i specializuar për analiza statike të trupave dhe sistemit të trupave.

Përmes këtij softueri mund të llogariten reaksionet e lidhjeve, forcat aksiale (N), forcat transfersale (T), momentet në përkulje (M), uljet – spostimet por edhe rastet e epjeve. Përveç vlerave numerike, ky softuer jep edhe diagramet përkatëse.

Një numër të konsiderueshëm të konstruksioneve – sistemeve është e mundur të realizohen përmes këtij softueri.

Mund të thuhet se është i specializuar për konstruksionet me shufra – traje ku mund të ngarkohen me çfarëdo lloji të ngarkesave.

Në vijim kemi paraqitur një pamje të dritarës kryesore të programit IQ 100 me veglat për vizatim – konstruktiv dhe ekzekutime.






















Fig.3.2. Softveri IQ 100

Shumica e llojeve të mbështetëse është e mundur të definohen në softuerin IQ 100, shih tabelën në vijim [15].

Mënyra e përgjithshme e definimit të mbështetëse	Përshkrimi i llojit të mbështetësit	Mënyra e definimit të mbështetëses në IQ100
	<b>Inkastrimi - ngulja</b>	
	<b>I palëvizshëm</b>	
	<b>I palëvizshëm me sustë</b>	
	<b>I lëvizshëm</b>	
	<b>I lëvizshëm me sustë</b>	
	<b>Pika e lirë</b>	
	Tri shufra të lidhura në një çërmierë, një e lirë dy të salduara	
	Shufra të lidhura në një çërmierë, një e lirë dy të salduara dhe sustat	
	<b>Nyja e Gerberit</b>	

Skema statike e rami




Fig. 3.1. Është paraqitur rami me ngarkesë kontinuele.



mbështetësi i palëvizshëm



mbështetësi i lëvizshëm




Fig. 3.2. Është paraqitur diagrami i momentit të përkuljes.




Fig. 3.3. Është dhënë diagrami i forcave transferzale.




Fig. 3.4. Është treguar diagrami i forcave normale.






Fig. 3.5. Forcat e reaksionit.

Llogaritja tabelare

STAB 1			
Stelle (absolut)	M [kNm]	Q [kN]	N [kN]
Knoten A	0.0	0.0	-30.57
Knoten B	0.0	0.0	-27.17

STAB 2			
Stelle (absolut)	M [kNm]	Q [kN]	N [kN]
Knoten B	0.0	26.23	0.0
x = 1.15	28.1808	22.78	0.0
x = 2.3	52.394	19.33	0.0
x = 3.45	72.6398	15.88	0.0
x = 4.6	88.918	12.43	0.0
x = 5.75	101.229	8.98	0.0
x = 5.75	101.229	-8.98	0.0
x = 6.9	88.918	-12.43	0.0
x = 8.05	72.6398	-15.88	0.0
x = 9.2	52.394	-19.33	0.0
x = 10.35	28.1808	-22.78	0.0
Knoten C	0.0	-26.23	0.0

Tab. 3.6. Janë treguar momentet, forcat normale dhe transferzale.

## KAPITULLI IV

### 4. MODELIMI I PJESËVE TË VINÇIT ME SOFTVERIN AUTODESK INVENTOR

Në modelimin e vinçit gjysmëportal do të aplikohet metoda e modelimit kompjuterik për arritjen e rezultateve. Për realizimin e këtij modeli mbështetemi në programin Autodesk Inventor 2016 i cili ofronë mundësinë e modelimit të tërësishëm kompjuterik të vinçit. D.m.th në këtë kapitull do të paraqiten modelet e vinçit me dimensione përkatëse të modeluara me softverin Inventor.




Fig. 4.1. Vinçi gjysmëportal i realizuar në softuerin Inventor 2016.




Fig. 4.2. Trau kryesor




Fig. 4.3. Trau anësor




Fig. 4.4. Karroca.







Fig .4.5. Polispasti



*Fig. 4.6. Rrota*



*Fig. 4.7. Mbajtësi i kushinetës*



*Fig. 4.8. Mbështetësi-kufizuesi*

## KAPITULLI V

### 5. ANALIZA E FORCAVE DHE MOMENTEVE TË PJESËVE KRYESORE TË VINÇIT GJATË NGRITJES SË NGARKESËS

#### 5.1. PROCESI I NGRITJES SË NGARKESËS

Procesi i ngritjes së peshës me ngarkesë maksimale 63 [kN]




Fig. 5.1. Vinçi gjysmëportal i dizajnuar për simulim në sofverin SimWise 4D.

Analizat e ngritjes së ngarkesës janë bërë me qëllim të fitimit të rezultateve gjatë punës së vinçit. Nga baza teorike, është vlerësuar se procesi i ngritjes është procesi më i vështirë dhe më kompleks në aspektin e studimit dinamik.

Analiza e ngritjes së ngarkesës maksimale  $Q = 63$  [kN] fillon me procesin e ngritjes së ngarkesës nga bazamenti dhe arrinë lartësinë maksimale të ngritjes deri në 4.15 m. Parametrat që do të kërkohen si rezultat janë forcat në litar, forcat në katër rrotat e vinçit gjysmëportal.

Analiza bëhet për shpejtësinë maksimale të ngritjes  $v_{ng} = 0.25$  [m/s]. Ngritja do të simulohet për lartësi nga bazamenti  $h = 0$  deri në lartësi  $h = 4.15$  [m]. Koha e simulimit është:  $t = 15$  [s].

## Forcat në litar ngritës dhe bartës




Fig. 5.2. Pamja e degëve të litarit ngritës të vinçit.

### 5.1.1. Forcat në litar ngritës dhe bartës gjatë ngritjes së ngarkesës.

#### *Forca në litar*

Forca në litar do të kërkohet për degët e litarit. Procesi i ngritjes përbëhet në tri faza:

- *Faza e parë*, paraqet procesin kur kemi inicim të mekanizmit së ngritjes, shtrëngim të litarëve bartës por jo ngritje të ngarkesës. Litarët ngritës nuk janë të ngarkuar.
- *Faza e dytë* fillon në intervalin kohor pas përfundimit të fazës së parë. Kemi ngritjen e ngarkesës
- *Faza e tretë* – Kemi ndalimin e ngritjes së ngarkesës në lartësinë maksimale të ngritjes. Më tutje nuk kemi ngritje, por kemi simulim për të analizuar lëkundjet e ngarkesës pa ngritje.



### Analiza e degëve të litarit

Në Fig. 5.3. është dhënë diagrami i forcës së degës së litarit me ngjyrë të zezë  $F_s = F_{ng}$ .

#### Konkluzion

- Faza e parë, zgjatë për kohën  $0 < t < 3.2$  [s]. Litarët ngritës nuk janë të ngarkuar.
- Faza e dytë fillon në intervalin kohor prej 3.22 [s] ku kemi ngritjen e ngarkesës, dhe ngritja mbaron gjatë intervalit kohor 15 [s]. Në këtë proces kemi lëkundje me amplituda të mesatare në pjesën  $3.22 < t < 15$  [s], ndërsa në pjesën në mes  $7 < t < 8$  [s] kemi lëkundje me mjaft frekuenca që shkojnë deri në 10 [Hz]. Në këtë fazë arrihet edhe vlera maksimale e forcës në këtë degë të litarit  $F_{\max}(\text{lit}) \approx 20000$  [N] në kohën  $t = 3.24$  [s]. Nëse e krahasojmë me vlerën statike të fituar në kap.2.9.2, që ishte  $F_s = 16.24$  [kN], raporti në mes të forcës dinamike dhe forcës statike është:

$$\Psi = \frac{F_{s\text{din}}}{F_{s\text{st}}} = \frac{20000}{16240} = 1.24 \text{ [kN]}$$

$\Psi$  – paraqet koeficientin dinamik të litarëve




Fig. 5.3. Grafiku i forcës në një degë litari me ngarkes maksimale 63 [kN].

- Faza e tretë – Kemi ngarkesën e ndaluar në lartësi  $h = 4.2$  [m]. Prosesi i simulimit vazhdon deri në  $t = 15$  [s]. Në këtë interval kemi lëkundje më të qeta, me amplituda më të vogla por me më pak frekuenca. Në këtë interval forca në litar është  $F_{\max}(\text{lit}) \approx 16575$  [N] për kohën  $t = 13$  [s], kjo forcë është e përafërt me forcën statike.

Nga diagrami i rezultateve grafike të forcës së degës të litarit me ngjyrë të zezë me ngarkesë maksimale si në fig. 5.1.2. konkludojmë se vlerat mesatare të forcave në litar janë të përafërta me rezultatet e llogaritjeve statike që i kemi paraqitur në kapitullin III. Gjatë simulimit të fazës së dytë vërejmë lëkundje me amplituda të mëdha, me frekuenca të theksuara që paraqet një natyrë të theksuar dinamike të ngarkimit të litarëve që mund të jenë shpjegim i arsyes së lodhjes dhe dëmtimit të litarëve.

### 5.1.2 Forcat në litar ngritës dhe bartës gjatë lëvizjes së karrocës.

Qëllimi i analizës gjatë lëvizjes së karrocës me ngarkesë maksimale  $Q = 63$  [kN] është fitimi i rezultateve që paraqesin sjelljen dinamike të karrocës gjatë lëvizjes drejtvizore. Parametrat e rezultateve që do të kërkohen si rezultat i kësaj analize janë: forca e litarëve, forca e katër mbështetësve të trarëve të sipërm, sforcimet në trarët kryesor të vinçit portal si dhe ngarkimi i konstruksionit metalik që bartë vinçi gjysmëportal.

- Analiza e simulimit gjatë lëvizjes së karrocës me ngarkesë maksimale  $Q = 63$  [kN].
- Analiza është bërë për shpejtësi maksimale të lëvizjes së karrocës të ngarkuar  $v_k = 0.25$  m/s .
- Koha e simulimit është 15 [s].
- Lartësia e ngarkesës është  $h = 1.35$  [m]

#### *Forca në litar*




Fig. 5.1.2. Grafiku i forcës në një degë litari me ngarkesë maksimale 63 [kN].

**Konkluzion:** Gjatë simulimit të lëvizjes së karrocës me ngarkesë maksimale të vinçit gjysmëportal kemi fituar rezultatet si në diagramin fig. 5.1.2. Konkludojmë se vlerat mesatare të forcës në litar janë të përafërta me rezultatet e llogaritjeve statike si në kapitullin II. Në këtë diagram vlera maksimale e forcës së litarit gjatë lëvizjes së karrocës me ngarkes është  $F_{\max}(\text{lit}) \approx 27500$  [N] në fillim të procesit të lëvizjes, në kohën  $t = 1$  [s].

Konkludojmë se litar i nënshtrohet një force dinamike me amplituda relativisht të larta dhe frekuenca të theksuara që shkaktojnë lodhjen e litarëve dhe mundësinë e dëmtimit të tyre.

### 5.1.3 Forcat në litar ngritës dhe bartës gjatë lëvizjes së vinçit gjysmëportal.

#### Forcat në litar




Fig. 5.1.3. Grafiku i forcës në një degë litari me ngarkes maksimale 63 [kN].

Nga diagrami i rezultateve grafike të forcës së degës të litarit me ngjyrë të kaltërt me ngarkesë maksimale  $F_{\text{lit}} = 44138$  [N], si në fig. 5.1.3. konkludojmë se vlerat mesatare të forcave në litar janë të përafërta me rezultatet e llogaritjeve statike që i kemi paraqitur në kapitullin III. Por, gjatë simulimit të fazës së dytë vërejmë lëkundje me amplituda të mëdha, në intervalin kohor në mes  $4 < t < 5$  [s] kemi lëkundje me amplituda  $16400 < A < 44138$  [N] dhe frekuenca

që shkojnë deri në 9 [Hz]. Kjo paraqet një natyrë të theksuar dinamike të ngarkimit të litarëve që mund të jenë spjegim i arsyes së lodhjes dhe dëmtimit të litarëve.

### 5.2.1 Forca në rrotën e vinçit gjatë ngritjes së ngarkesës




